



REPUBLIKA E BHQIPERISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Tiranë më 07.07.2023

Lënda: Kërkesë për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin/heqjen e lirisë dhe ushtrimin e kontrollit personal/të banesës së deputetit

Baza Ligjore: Neni 73 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,
Neni 288 i K.Pr.Penale,
neni 13, 118 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Objekti:

1. Dhënia e autorizimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për
 - arrestimin/heqjen e lirisë dhe
 - ushtrimin e kontrollit personal dhe të banesës së deputetit **Arben AHMETAJ**
2. Shqyrtimi i kësaj kërkesë, në pdo procedurë që do të zhvillohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, të bëhet në seancë me dyer të mbyllura, për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor.

Drejtuar: **Znj. Lindita NIKOLLA**
KRYETARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

E Nderuar znj. Kryetare e Kuvendit!

Mbështetur në nenin 73 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 288 të K.Pr.Penale, si dhe në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 118, parashtrojmë kërkesën për dhënien e autorizimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për arrestimin/heqjen e lirisë dhe ushtrimin e kontrollit personal dhe të banesës së deputetit:

- **Arben AHMETAJ**, i biri i Nevruz dhe i Ferdane, datëlindja 28.06.1969, lindur në Gjirokastër

Ky shtetas, rezulton se ka marrë cilësinë e personit nën hetim, në kuadrin e procedimit penal nr. 277/1 të vitit 2022, pasi dyshohet se ka kryer veprat penale të:

- “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, vetëm dhe në bashkëpunim, në formën e deklarimit të rremë, dhe në formën e fshehjes, parashikuar nga neni 257/a paragrafi i ytë nen 25 K Penal,
- “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” parashikuar nga neni 260 i K.Penal, 6 (gjashtë) herë;
- “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim, më shumë se një herë parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë i K.Penal;

Konkretisht nga aktet rezultojnë se:

Prokuroria e Posaçme Kundër Komisionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, ka regjistruar fillimisht procedimin penal nr. 277 të vitit 2020, për veprat penale të “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, “Korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo të veprimtarisë kriminale” në bashkëpunim, të parashikuara respektivisht nga nenet 248 e 25, 260, 245 dhe 25, 287 të K.Penal.

Në themel të hetimit të mësipërm, ka qenë procedura e dhënies me koncension shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k. për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë në vitin 2014 si dhe zbatimi në vijim i angazhimit të marrë përsipër nga shoqëria Albtek Energy sh.p.k.

Pas kryerjes së hetimeve në kuadrin e procedimit penal nr. 277 të vitit 2020, rezultojnë se prokuroria ka kërkuar dërgimin për gjykim të disa të pandehurëve, e konkretisht shtetasve Lefter Koka, me detyrë Ministër Mjedisi në kohën e ndodhjes së fakteve penale, Alqi Bllako me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Pëllumb Abeshi, Bardhul Çabiri, Serafin Papa, Etleva Kondi, Jonida Zeqo, Mirel Mërtiri, Stela Gugallja, Klodian Zoto, shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k, me Nipt L4I914013H dhe shoqëria “Integrated Technology Services” sh.p.k, me Nipt L02302032C. Me vendimin nr. 21 date 21.02.2023 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Komisionin dhe Krimin të Organizuar Tiranë, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 277 të vitit 2020 ndaj të pandehurëve e të sipërcituar.

Me vendimin e datës 19.09.2022, prokurori i qështjes ka vendosur ndërkohë ndarjen e procedimit penal nr. 277 të vitit 2020 në disa procedime penale të tjera e ndër të tjera në procedimin penal nr. 277/1 të vitit 2022, në kuadrin e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Gjithashtu, mbështetur në kallzimin penal nr. K158 prot datë 22.02.2023 (hyrje në prokurori) të shtetasit Adriatik Doei, është regjistruar procedimi penal nr. 30 datë 24.02.2023 për veprat penale U “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar respektivisht nga nenet 260, 257/a dhe 287 i K.Penal.

Procedimet penale nr. 277/1 i vitit 2022 dhe nr. 30 i vitit 2023, janë bashkuar në një procedim penal të vetëm e konkretisht ai me nr. 277/1 i vitit 2022, duke vijuar tashmë hetimet për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i qdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar respektivisht nga nenet 248, 260, 257/a dhe 287 i K.Penal.

Shtetasi Arben Ahmetaj, mban cilësinë e personit nën hetim, në kuadrin e hetimeve që po kryhen për procedimin penal nr. 277/1 të vitit 2022.

Hetimet në kuadrin e procedimit penal nr. 277/1 të vitit 2022, janë shtrirë në kuadrin e parimit të një hetimi të gjithëanshëm, në rolin që ka pasur shtetasi Arben Ahmetaj, jo vetëm në kuadrin e procedurës për dhënien me koncension të projektit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë, por edhe në atë për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë si dhe ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë.

Në lidhje me procedurën për dhënien me koncension për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë, Prokuroria e Posaçme kishte regjistruar ndërkohë procedimin penal nr. 187 të vitit 2020 për veprat penale të “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendor”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim, “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë të shtetërorë ose i të zgjedhuve vendor”, në bashkëpunim, “Mashtrimi”, me pasoja të rënda, në bashkëpunim, “Krijimi i skemave mashtruese në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248, 25, 260 të Kodit Penal, 287; 245 e 25, 244, 143/3 e 25, 144/a e 25 i K.Penal. Në përfundim të hetimit, kërkoi dërgimin për gjykim të çështjes në ngarkim të të pandehurëve Lefter Koka, Alqi Bllako, Pëllumb Abeshi, Etleva Kondi, Sabina Cenameri, Florjan Muçaj, Azem Shateri, Erjon Murataj, Arben Dervishaj, Klodian Zoto, Arenc Myrtezani, Loran Dusha, Giuseppe Ciaffaglione, Arjola Kodra, Arbër Denizi, Juri Ymeraj, Silvestër Driza, Regan Merdani, Robert Shabani, Enver Sheshi, Gentian Zifla, shoqërive “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k, “Integrated Technology Service” sh.p.k, “Sili” sh.p.k, “J.P.Y” sh.p.k, “Pivot 04” sh.p.k, “Best Services” sh.p.k, “Froggy 03” sh.p.k, “General Servis” sh.p.k, “Itneg” sh.p.k, “Leli-1 /” sh.p.k, “Pupa Services” sh.p.k”, “RSI & T Group” sh.p.k, “Froggy”sh.p.k. Me vendimin nr. 26 date 24.03.2023 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesës së prokurorisë dhe dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 187 të vitit 2020 ndaj të pandehurëve të sipërcituar, përveç disponimit për pushimin e çështjes të të pandehurëve Enver Sheshi dhe Robert Shabani.

Deri në këtë fazë të hetimit, në kuadrin e procedimit penal nr. 277/1 të vitit 2022, pasur parasysh provat e administruara, është formësuar dyshimi i arsyeshëm, se shtetasi Arben Ahmetaj, përgjatë kohës që ka ushtruar funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipëri së, Ministrit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si dhe gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e Ministrit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ka konsumuar veprën penale të “Korrupsionit pasiv të funksionarit të lartë shtetërorë ose i të

zgjedhurve vendorë”, parashikuar si e tillë nga neni 260 i K.Penal, pasi ka marrë drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, përfitim të parregullt, për vete ose persona të tjerë, e konkretisht:

- Shumën pret prej 170 480 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) euro, në vitin 2016 dhe 2017, duke u mbuluar natyra e vërtetë e burimit dhe duke u paraqitur si pagesë e bërë shtetasve Albina Mançka dhe Arben Ahmetaj, përkundrejt një "shitje" ndaj shtetasit Andi Boni *ipagese e kryer ne perfundim nga shtetasi Helidon Begaj*, të 2 (dy) apartamenteve me sip 124.15 m² dhe me sip 148.8 m², ndodhur në ZK 3292, në vendin e quajtur Selitë, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria "Sheron" sh.p.k., vlerë kjo e paguar në mënyrë të tërthortë nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri nëpërmjet shtetasve Andi Boni dhe Helidon Begaj;
- Pasurinë truall + ndërtesë me nr pasurie 1/110 vol 12 faqa 26 ZK 1925 me sip truall 521.13 m² dhe sip ndërtese 98 m² ndodhur në NB Hamallaj, e identifikuar si Vila Saphire nr. 22, e përfituar ne vitin 2017, nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet transaksioneve të kalimit më parë të kësaj pasurie në emer të shtetasit Klodian Zoto, në vijim ne emer te shtetasit Gerian Kuka e më pas në pronësi të shtetases Erjola Hoxha, bashkëjetuese e personit nen hetim Arben Ahmetaj.
- Shumën Dri 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) euro, në vitin 2017 dhe 2018, duke u mbuluar natyra e vërtetë e burimit dhe duke u paraqitur si pagesë e bërë shtetasve Albina Mançka dhe Arben Ahmetaj, përkundrejt një "shitje" ndaj shtetasit Besmir Prifti, të 1 (një) apartamenti me sip 178.68 m² dhe 1 (një) garazhdi, me stp 21 m², ndodhur në ZK 3292, në vendin e quajtur Selitë, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria "Sheron" sh.p.k., vlerë kjo e paguar në mënyrë të tërthortë nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, dhe subjekti tregtar "Integrated Technology Services" sh.p.k. nëpërmjet shtetasit Besmir Prifti;
- Shumën pret 140 000 (njëqind e dyzetë mijë) euro, në vitin 2018, duke u mbuluar natyra e vërtetë e burimit dhe duke u paraqitur si pagesë e bërë shtetasve Albina Mançka dhe Arben Ahmetaj, përkundrejt një "shitje" ndaj shtetases Sonila Goxhaj, të 1 (një) apartamenti me sip 178.68 m² dhe 1 (një) garazhdi, me sip 21 m², ndodhur në ZK 3292, në vendin e quajtur Selitë, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria "Sheron" sh.p.k., vlerë kjo e paguar në mënyrë të tërthortë nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, nëpërmjet shtetasve Sonila Goxhaj, Sokol Meqemeja dhe shoqërisë "Frigo Food" sh.p.k.
- Shumën pret rreth 34 422 (tridhjetë e katër mijë e katërqind e njëzetë e dy) euro, të përfituar ne formen e shpenzimeve per pagesa hotelesh apo udhëtimesh, përgjatë periudhës 2013 — 2017, pagesa këto, të kryera drejtëpërdrejtë nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, për shtetasin Arben Ahmetaj apo të atërm të tij.
- Shumën në total orei 2 007 373 (dy milionë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, në vitin 2019 dhe 2020, në formën e pagesave të kryera ndaj subjekteve tregtare të ndryshme, nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, nëpërmjet shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k., në funksion të një investimi të kryer në pasurinë e llojit apartament me nr. 7/434+1 -1 sip 167 m², miga Reshit Çollaku, ap.1. në pronësi të shtetasit Arben Ahmetaj;

Sa më lart, vlerësohet se janë përfitime të parregullta, të dhëna personit nën hetim Arben Ahmetaj, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, me qëllim kryerjen ose moskryerjen e veprimeve që lidhen me detyrën dhe funksionin e tij, sjellje kjo e personit nën hetim që i ka mundësuar shtetasve Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri dhe subjekteve tregtare të regjistruara

në emër të tyre apo të afërmeve të tyre apo të kontrolluara prej tyre, lidhjen e kontratave, në kuadrin e procedurave koncensionare të nisura nga Autoriteti kontraktor Ministria e Mjedisit e konkretisht:

- Procedura koncensionare: me objekt *“Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit për prodhimin e energjisë”*, për të cilën është lidhur kontrata mes Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë *“Alblek Energy”* sh.p.k., me nr. 11026/7 prot datë 16.12.2014,‘
- Procedura koncensionare: me objekt *“Për ndërtimin e administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”*, për të cilën është lidhur kontrata mes Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë *“Integrated Technology Wasle Treatment Fier”* sh.p.k. nr. 5553/5 datë 24.10.2016;
- Procedura koncensionare: me objekt *“Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabffifim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike Zona e trajtimit të mbetjeve Tiranë (ZTMT)”* për të cilën është lidhur kontrata mes Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë *“Integrated Energy BY SPV”* sh.p.k. me nr. 6021 rep nr. 2895 kol datë 31.08.2017.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, nga hetimet e kryera deri më tani, dyshohet se ka shtënë në dorë përfitimet e parregullta si më sipër, për shkak të sjelljes si funksionar si më poshtë vijon:

Në lidhje me procedurën me objekt *“Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit për prodhimin e energjisë”*, personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nëpërmjet vartësit të tij, të ndjerit Zamir Stefani, ka kontribuar në dhënien e koncensionit, në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullues, duke u zbatuar procedura e negocimit pa shpallje paraprake si dhe duke mos u zbatuar detyrimet e tjera të ngarkuara nga kuadri ligjor në fushën e koncensioneve, përgjatë procedurave të ndjekura nga anëtarët e komisionit të sipërcituar, pjesë e të cilit ka qenë edhe i ndjeri **Zamir Stefani**.

Me shkresën nr. 7975/1 prot datë **14.11.2014** është **shprehur parimisht dakort**, në lidhje me projekt vendimin për përcaktimin e autoritetit kontraktues Ministrinë e Mjedisit, procedurën përzgjedhëse me negocim **pa shpallje paraprake të njoftimit** të kontratës që i jepet shoqërisë **Alb — Tek sh.p.k.** në procedurën koncensionare me objekt *“Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit për prodhimin e energjisë”*. Kjo shprehje dakordësie vjen në kundërshtim me kuadrin ligjor në fushën e koncensioneve kur nuk mund të zbatohet procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Gjithashtu, në asnjë moment nuk ka ngritur shqetësimin, se cila ishte shoqëria propozuese, paaftësia e saj teknike, ekonomike për kryerjen e një veprë të tillë.

Në lidhje me procedurën me objekt *“Ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”*, personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, paraprakisht ka ndërmarrë nisma ligjore (me vendimin nr. 325 datë **22.04.2015** të nënshkruar nga vetë Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, shtetasi Arben Ahmetaj, janë propozuar disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013, ndryshime këto të miratuara në datë 16.07.2015) me qëllimin e vetëm, përforcimin e rolit të tij dhe të organeve në varësi të tij

(Atrako), në procedurat koncensionare. Gjithashtu është propozuar dhe në vijim miratuar, që propozuesit të pakërkuar t'i jepej bonus, gjë e cila është arritur dhe është përdorur pikërisht në rastin e projektit koncensionar të Fierit, ku i është dhënë bonus, një shoqërie të lidhur me shtetasit Sokol Meqemeja (*bashkëjetues i shtetases Sonila Goxhaj*), Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, **ka qenë vazhdimisht në dijeni të problematikave** që evidentonte Ministria e Financave dhe pengesat që kjo e fundit po nxime për miratim, në lidhje me procedurën koncensionare me objekt *“Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit për prodhimin e energjisë”*, apo edhe me diskutimet e komisionit, siç edhe lexohet nga emaili i datës **06.12.2014** kur shtetasi Ervin Mete i ka nisur në këtë datë emailin e përcjellë nga shtetasi Alqi Bllako, me materialin e përgatitur nga komisioni në lidhje me pikat e diskutuara dhe me pikat e diskutimit të Ministrisë së Financës.

Me shkresën nr. 429/1 prot datë **19.01.2016**, personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, **ka shprehur dakordësinë për** Seljen e investimeve nga Ministria e Mjedisit, detajimin e tyre për vitin 2016, në lidhje me *Inceneratorin e Elbasanit* në shumën 550 000 000 lekë, *Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet Fier* 73 330 000 lekë; *Pastrimi i lumit Shkumbin* 130 000 000 dhe *Mbyllja e vendepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta urbane të qytetit të Elbasanit* 740 000 000 lekë, ku në të katërta **këto procedura, janë pikërisht miqtë e tij**, shtetasit **Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri që në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë, kanë përfituar të ardhura.**

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka ndërmarrë nisma ligjore (*me shkresën nr. 8026722 prot datë 28.01.2016, shtetasi Arben Ahmetaj, në pozicionin e Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes paraqet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, projekt vendimin për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 575 datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncensioUpartneritet publik privat” të ndryshuar*) në lidhje edhe me ndryshimin e VKM nr. 575 datë 10.07.2013, ne koherencë me ndryshimet e ligjit për koncensionet te propozuara po prej tij, ku rritet pushteti i Ministrisë që ai drejton dhe i Atrako.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me shkresën nr. 367/2 prot datë 01.02.2016 ka shprehur dakordësinë e tij për projekt vendimin **“Për miratimin e Bennett, prej 10 (dhjetë)% të pikëve, që i jepet shoqërisë “Building & Green Energy” për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, për dhënien me kon sion, të ndërtimit dhe administrimin të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”**. Këtë përgjigje e ka dhënë pikërisht në kohën kur në këtë shoqëri ishte bërë ortak shoqëria Integrated Technology Services sh.p.k. e shtetasit Klodian Zoto. Në dhënien e kësaj dakordësie, nuk ka ngritur asnjë shqetësim në lidhje me historikun e kësaj shoqërie, aftësitë e saj financiare apo teknike.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, me shkresën nr. 6770/1 prot datë 24.05.2016, ka miratuar transferimin e fondeve për investime, duke i shtuar projektit *“Mbyllm e vendepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta urbane të qytetit të Elbasanit”* shumën prej 177 500 000 lekë dhe pakësuar projektit *“Impiantit të Prodhimit të energjisë nga*

mbetjet në Fier” shumë prej 60 000 000 lekë, si dhe projektin të “Inceneratorit të Elbasanit” shumë prej 40 000 000 lekë, **me qëllim pagesën e punëve shtesë për IV “Ndërtim Montim Patos dhe GjikuFia” për objektin “Zhvendosja e mbetjeve të ngurta urbane nga venddepozitimi ekzistues Elbasan dhe bonifikimi i zones”, nie vlerë shtese kontrate 137,988,830.833 lekë** pa tvsh. Ky bashkim operatorësh ka bashkëpunuar me shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri për fitimin e këtij prokurimi, duke qenë subjekt i parazgjedhur prej tyre në bashkëpunim me funksionarët që kanë realizuar procedurën.

Më datë **02.06.2016**, miratohet ligji Nr. 57/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku evidentohet parashikimi i nenit 4/2 me këtë parashikim: **“Ministria e Financave vlerëson dhe miraton R-r-prakisht, të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve, individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.”**

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, me shkresën nr. 8264/1 prot datë **27.06.2016** është shprehur se **janë përmbushur në tërësi kriteret e përcaktuara nga VKM nr. 57572013 i ndryshuar** në lidhje me vijimin e procedurave të koncensionit, në rastin e projektit koncensionar të Fierit të sipërcituar, miratim ky i ardhur pas pengesës që po i bëhej kësaj procedure nga ana e paraardhësit të tij, ish Ministrit të Financave shtetasit Shkëlqim Cani, duke pasqyruar si mangësi **përveç detyrimit që në zbatim të nenit 22 të VKM nr. 575/2013 autoriteti kontraktor (Ministria e Mjedisit) duhet të garantojë mbulimin e kostove financiare, brenda tavaneve afatmesme të miratuara të shpenzimeve të saj.** Shkresa e mësipërme është nënshkruar vetëm pas komunikimeve të datave 17.06.2016, 20.06.2016, 21.06.2016, 22.06.2016 që janë shkëmbyer ndërmjet shtetasve Alda Klosi (funksionare e Ministrisë së Financave), Alba Thoma, Gentian Opre (funksionar i Ministrisë së Financave), Etleva Kondi, Alqi Billako, Gelardina Prodani (funksionare e Ministrisë së Financave), Mimoza Dhëmbi (funksionare e Ministrisë së Financave), emaile këto që më pas përcilleshin nga shtetësja Alba Thoma tek shtetasi Klodian Zoto dhe ky i fundit tek shtetësja Etleva Kondi. Shkresa e mësipërme është nënshkruar vetëm pas komunikimeve nëpërmjet emaileve që shtetasi Klodian Zoto ka bërë në kuadër të redaktimit si dhe plotësimeve të mangësive të evidentuara, në datat 18.06.2016, 19.06.2016, 20.06.2016, 22.06.2016 me shtetasit, Sevi Zani, Erton Kaleshi, Alba Thoma, Etleva Kondi. Megjithëse me memot përkatëse, punonjësit në varësi të personit nën hetim Arben Ahmetaj, janë përgjigjur mbi mangësitë dhe më datë 15.06.2016 rezultoi se shtetësja Alda Klosi ka përgatitur edhe kthimin e përgjigjes ku rendit të gjitha këto mangësi, personi nën hetim Arben Ahmetaj, nuk ka nxituar të kthejë përgjigje negative por i është lënë koha dhe mundësia shtetasve Zoto dhe Mërtiri për të rregulluar ato, duke u përdorur funksionarë të ministrisë që personi nën hetim kishte në varësi si dhe me ndihmën e shtetaseve Alba Thoma dhe Etleva Kondi.

Me propozimin e personit nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, është miratuar VKM nr. 515 datë **13.07.2016** “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të prograirit të buxhetor afatmesëm 2017 — 2019” e cila shfuqizon VKM nr. 230 datë 30.03.2016, ku konstatohet se Ministrisë së Mjedisit i rritet tavanin i sipërcituar nga vlera 2, 18 milionë lekë në 3, 313 milionë lekë.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, pas miratimit të VKM së mësipërme, me shkresën nr. 8264/4 prot datë **08.09.2016** është shprehur në **parim dakort me mbështetjen financiare** referuar projektin koncensionar të Fierit, të sipërcituar, por duke

pretenduar se duhet të vlerësoheshin me prioritet *kostot buxhetore që mund të lindin si pasojë e materializimit të risqeve të ndryshimit të kursit të këmbimit dhe atij* nga inflacioni, të përlllogariten plotësisht brenda totalit të parashikuar si mbështetje financiare për këtë projekt, 'Marrjen e miratimit nga MEI në cilësinë e institucionit përgjegjës për politikën në fushën e energjisë elektrike dhe pronarit të KESH sh.a. për përballimin e riskut nga çmimi i energjisë elektrike (feed in tariff), 'Marrjen e miratimit nga njësitë e qeverisjes vendore që përfshihen në këtë projekt, lidhur me përballimin prej tyre të riskut të mosplotësimit të sasisë së mbetjeve për t'u trajtuar nga konkensionari. Këto çështje, që personi nën hetim Arben Ahmetaj, ka parashtruar se duhet të vlerësoheshin me prioritet, janë përcaktuar nga shtetësja Alda Klosi në shkresën draft të përgatitur që më datë 23.06.2016, por që personi nën hetim nuk ka vlerësuar t'i rendisë në shkresën me shkresën me nr. 8264/1 prot datë 27.06.2016, kur është shprehur se në tërësi janë përmbushur kriteret.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, me shkresën nr. 14925/1 prot datë **03.11.2016** ka miratuar "Rialokim fondi në investime për buxhetin e vitit 2016" ku konstatohet se për projektin "Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier" është pasqyruar vlera prej 26 449 329 lekë.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, me shkresën nr. 15402/1 prot datë **3#.J/.2#S6** në lidhje me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit për shprehjen e dakordësisë për dhënien e bonusit, në lidhje me projektin "Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike Zona e trajtimit të mbetjeve Tiranë (ZTMT)", nuk e pengon, duke u justifikuar se **është një akt me karakter individual**, megjithëse nxjerr disa problematika dhe sugjeron që përpara dhënies së bonusit nëse kërkohet mbështetje financiare duhet të merret miratimi paraprak nga ana e Ministrisë së Financave. Pra nuk i ka vendosur barrierë kësaj nisme, megjithëse prej vetë Ministrisë që ai drejton, janë pasqyruar shumë qartë shqetësimet se ky projekt do të kishte efekte në buxhetin e shtetit.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, me shkresën nr. 17366/27 prot datë **22.32.2016**, ka miratuar detajimin e fondeve për investime Inceneratori i Elbasanit me vlerë 4 023 870 lekë.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, me shkresën nr. 17397/1 prot, datë **22.12.2016** është shprehur **pa vërejtje në parim**, për projektin vendimin e Këshillit të Ministrave "**Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë"** duke dhënë edhe arsyetimin se kjo dakordësi jepet për aq kohë sa, në relacionin shoqërues të projektit vendimit është përcaktuar se efektet financiare do të përballohen nga buxheti i bashkisë Fier, e cila ka konfirmuar parashikimin e fondit të nevojshëm të vlerës së shpronësimit në buxhetin e saj për vitin 2017.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, me shkresën nr. 17911/177 prot datë *2fi. fi.J.2fi 7* ka miratuar detajimin e fondeve, për shpenzime kapitale në financim të brendshëm dhe të huaj për vitet 2017 — 2019 ku për projektet informatike fondi është çelur i ngjirë pasi duhet marrë më parë konfirmimi nga Akshi për këto projekte. Kështu për Incenermtorin e Elbasanit, është: Buxheti i vitit 2017 në vlerën 553 119 000 lekë; Buxheti i Vitit 2018 në vlerën 662 502 000 lekë; Buxheti i vitit 2019 në vlerën 661 502 000 lekë. Për impiantin e prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier është: Buxheti i vitit 2017 në vlerën

590 000 000 lekë; Për vitin 2018 në vlerën 750 209 000 lekë; Për vitin 2019 në vlerën 780 000 000 lekë.

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, në muajin janar 2017, ka ndërmarrë sërish një nismë ligjore, referuar edhe shkresës me nr. 653/2 prot datë **30.01.2017** drejtuar ministrive dhe KPP si dhe APP duke i dërguar për mendim projektvendimin “*Për disa ndryshime në VKM nr. 575 datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat” së bashku me relacionin përkatës. Në këtë projekt vendim, propozimet që janë ndryshuar, kanë të bëjnë pikërisht me rritjen e rolit të Ministrisë së Financave në procedurat koncensionare, duke u kërkuar që **çdo projekt koncensionar, duhet të vlerësohet dhe miratohet paraprakisht nga Ministria e Financave, pavarësisht nëse kërkohet apo jo mbështetje financiare.** Gjithashtu është parashikuar që duhet të vlerësohen dhe të miratohen paraprakisht nga Ministria e Financës edhe projektet e koncensionave/PPP që pësojnë ndryshime të kontratës apo transferim të saj, pavarësisht nevojshmërisë ose jo për mbështetje financiare. Si përfundim me VKM nr. 146 datë **22.02.2017** janë miratuar ndryshimet përkatëse në VKM nr. 575 të vitit 2013, duke ngelur ndryshimet e propozuara por duke u shtuar disa afate.*

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, në lidhje me projektin “*Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike Zona e trajtimit të mbetjeve Tiranë (ZTMT)”, me shkresën mx. 13118/9 prot datë **06.04.2017** është shprehur **pa komente, për vazhdimin e procedurës koncensionare,** përsa kohë që financuesi dhe përfituesi kryesor i projektit është Bashkia Tiranë, por duke i kërkuar të vlerësohen me *prioritet maksimal disa qëshje si kostot buxhetore që mund të lindin si pasojë e materializimit të risqeve të ndryshimit të kursit të këmbimit dhe atij’ nga inflacioni; Marrjen e miratimit nga MEI, Marrjen e miratimit nga njësitë e qeverisjes vendore.* Në këtë procedurë minimalisht nuk duhet të ishte mjaftuar me pëlqimin vetëm të njëjës bashki që prekej nga ky projekt.*

Personi nën hetim Arben Ahmetaj, si Ministër i Financave, me shkresën nr. 8619/1 prot datë **07.05.2017** drejtuar Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë, është shprehur **në parim dakord,** në lidhje me projekt vendimin “*Për miratimin e rapashikimit të financimit të nevojshëm për plotësimin e detyrimeve kontraktore në kontratën e koncensionare nr. 6021 ref nr. 2894 datë 31.08.2017 “Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese në Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike, zona e trajtimit të mbetjeve Tiranë (ZTMT)”,* por duke kërkuar riformulim të disa pikave.

Në konkluzion, pasur parasysh, se të tre këto procedura kanë rezultuar me problematika të theksuara që kanë sjell dëm në buxhetin e shtetit, ku tashmë për dy të parat, Elbasanin dhe Fierin, kemi edhe vendimmarrje të gjykatave për dërgimin e pështjes për gjykim, qoftë në lidhje me shkelje ligjore të ndodhura në procedurat e ndjekura ashtu edhe në lidhje me punime të pakryera, me pagesa fiktive, konstatohet se që në lindjen e këtyre procedurave e deri në përfundimin e tyre dhe përsa kohë që edhe janë kryer pagesa në kohën që shtetasi Arben Ahmetaj ka ushtruar detyrën e Ministrit të Financave, tregojnë më së qarti se roli i personit nën hetim Arben Ahmetaj, ka qenë i tillë që, përveqse nuk është bërë pengues, ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova, se është shpërblyer për çdo miratim të dhënë prej tij.

Përveç sa parashtrohet në relacionin që i bashkalidhet kësaj kërkesë, që mbështesin dyshimin e arsyeshëm mbi kompsionin pasiv të personit nën hetim Arben Ahmetaj, kryer si më lart

cituar, i realizuar përkundrajt sjelljes që duhet të mbante dhe ka mbajtur për këto procedura koncensionare, realizuar për shkak të marrëdhënies së ngushtë që personi nën hetim Arben Ahmetaj ka pasur me shtetasit Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto, vlerësojmë të evidentojmë se: Sjellja e tij, në drejtim të përfundimit me sukses të kontratave koncensionare, në favor të shoqërive të kontrolluara drejtëpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë nga shtetasit Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto, ekziston dyshimi se është shoqëruar edhe me kontakte të drejtëpërdrejta me punonjës/funksionarë të përfshirë në këto procedura koncensionare, ku vetë apo nëpërmjet vartësve të tij, ka ushtruar presion, duke kërkuar realizimin me sukses të procedurave koncensionare, pavarësisht mangësive që paraqisnin.

Shtetësja Sidita Kopliku (Temali), anëtare në komisionin për zhvillimin e procedurës koncensionare të Tiranës, si përfaqësuese e Atrako, në deklarin e saj më datë 07.07.2023, ka deklaruar se ka pasur presione nga titullarja e e institucionit, Agjensisë së Trajtitimit të Konkencioneve, konkretisht shtetësja Rovena Beqiraj, ku prej saj nxitej që procedura koncensionare për Tiranën të finalizohet me sukses. Gjithashtu sqaron se, kur ka qenë pjesë e procedurës koncensionare në lidhje me Durrësin ku do të ndërtohej një landfill, si anëtare komisioni, një këshilltar i ministrit Arben Ahmetaj, e ka njoftuar që e kërkonte ministri Arben Ahmetaj në zyrë. Ka shkuar tek zyra e ministrit Arben Ahmetaj, në paradhomë, ku sekretarja i ka kërkuar të linte telefonin aty, dhe më pas është futur në zyrën ku ndodhej ministri Arben Ahmetaj, e shoqëruar nga këshilltari. Në zyrë kanë qenë vetëm të tre, pra Sidita, këshilltari dhe ministri Arben Ahmetaj. Ministri Arben Ahmetaj i ka kërkuar që, në lidhje me procedurën e Durrësit, Sidita ta shikonte dhe ta vlerësonte me pozitivitet, në drejtim të përfundimit me sukses të saj. Sidita këtë takim e ka vlerësuar si formë presioni pasi titullar të drejtëpërdrejtë ajo kishte kryetarin e Atrako-s. Pas kësaj situatë, edhe në rastin e procedurës koncensionare të Tiranës, Sidita është ndjerë në presion për shkak të asaj që kishte ndodhur për Durrësin dhe pasur parasysht edhe nxitjen e kryetares Rovena Beqiraj që kjo procedurë koncensionare e Tiranës të realizohej me sukses.

Duke sjellë në vëmendje se, vepra penale e korrupsionit, është një vepër penale që gjen zbatim edhe ndaj funksionarit që kërkon ose merr drejtëpërdrejtë ose tërthorazi çdo lloj përfitimi të parregullt apo qoftë edhe premtimin për një përfitim të tillë, për vete ose të tretë apo pranimi i ofertës ose premtimit që vjen nga përfitimi i parregullt, **qohet e konsumuar në raport me sjelljen që ka pasur funksionari në kuadrin e ushtrimit të funksionit të tij, qoftë kjo sjellje edhe sipas ligjit fra e pashoqëruar me shpërdorim detyrë**), vlerësojmë se në rastin konkret është konsumuar plotësisht vepra penale e komipsionit pasiv nga funksionari i lartë personi nën hetim Arben Ahmetaj.

Gjithashtu, nga të dhënat e administruara përgjatë këtij hetimi, ekziston dyshimi i arsyeshem, i mbështetur ne prova, se shtetasit Albina Mançka dhe Arben Ahmetaj, kanë porositur dhe fituar pronesine që në vitin 2019, të një vile të identifikuar si vila me nr 73 ndodhur në Green Coast, Palasë, e porositur me kontratë sipërmarrje nga shoqëria Inerte Express sh.p.k., me ortak shtetasin Mond Bega, kaluar në vijim, me qëllim të fshehjes së pronarit të vërtetë, shtetases Elda Dinaj, mikeshë e ngushtë e shtetases Albina Mançka. Kjo vilë nuk është deklaruar ndonjëherë në deklaratat e pasurisë që shtetasit Arben Ahmetaj dhe Albina Mançka kanë dorëzuar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Deri më tani ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se kjo vilë është përfituar me të ardhura që nuk mund të justifikohen me burime të ligjshme.

Persa me siper, vlerësojmë se ekziston dyshimi se nga ana e personit nën hetim Arben Ahmetaj, është konsumuar edhe vepra penale e “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*” vetëm ose në bashkëpunim, në formën e deklarimit të rremë, dhe në formën e fshehjes, parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë e 25 i K.Penal, përse i përket:

- Deklarimit të rreme të shumës së investuar dhe burimit të saj, për ndërtimin e një pallati të ndodhur tek vendi i quajtur Shallvare, bashkë me shoqërinë “*Lani*” sh.p.k., shtetasit Vladimir Kosta dhe Ervin Manushi. Prej shtetasve Arben Ahmetaj dhe Albina Mançka është pasqyruar nder vite, në deklaratat e pasurive të dorezuara në Inspektoriatin e Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, se shuma me përafërsi 105 000 euro ose 102 500 euro ose 105 000 euro, ka si burim kursimet, kredi bankare pranë ISP Bank në vlerën 100 000 euro dhe nga shitja e pjeseve takuese të investimit. Nga hetimet ka rezultuar se, kredia e referuar si burim, ka pasur si qëllim blenjen e një apartamenti dhe për më tepër kjo kredi është disbursuar në llogarinë këtyre shtetasve me datë 24.08.2016, ndërkohe që pjesa më e madhe e investimit të mesiperm, është kryer në periudhën janar 2004 — korrik 2006.
- Fshehjes së shumës 3 123 880.3 leke gjithsej, të paguar përgjate viteve 2019 dhe 2020, në investimin e bërë për rregullimin/punime në ambjentin e brendshëm AIRBN e cila ndodhet në katin e dytë, të pallatit të ndërtuar me bashkeinvestitorët shoqërinë “*Lani*” sh.p.k., shtetasit Vladimir Kosta dhe Ervin Manushi.
- Fshehjes së shumës 2 007 373 lekë gjithsej, të paguar përgjate viteve 2019 dhe 2020 nga shoqëria Integrated Technology Services sh.p.k. në investimin e bërë për rregullimin/punime në ambjentin e brendshëm AIRBN e cila ndodhet në katin e dytë, të pallatit të ndërtuar me bashkeinvestitorët shoqërinë “*Lani*” sh.p.k., shtetasit Vladimir Kosta dhe Ervin Manushi;
- Fshehjes së shumës prej prej 170 480 euro, në vitin 2016 dhe 2017, dhe deklarimi i rreme i burimit të saj, duke u mbuluar natyra e vërtetë dhe duke u paraqitur si pagesë e bërë shtetasve Albina Mançka dhe Arben Ahmetaj, përkundrejt një “shitje” ndaj shtetasit Andi Boni *ipagese e kryer në perfundim nga shtetasi Helidon Begaj*), të 2 (dy) apartamenteve me sipërfaqe 124.15 m² dhe me sipërfaqe 148.8 m², ndodhur në ZK 3292, në vendin e quajtur Selitë, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “*Sheron*” sh.p.k., vlerë kjo e paguar në mënyrë të tërthortë nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri nëpërmjet shtetasve Andi Boni dhe Helidon Begaj;
- Fshehjes së pasurisë dhe deklarimit të rreme të saj, truall + ndërtesë me nr pasurie 1 /110 vol 12 faqa 26 ZK 1925 me sipërfaqe 521.13 m² dhe sipërfaqe 98 m² ndodhur në NB Hamallaj, e identifikuar si Vila Sapphire nr. 22, e përfituar në vitin 2017, nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet transaksioneve të kalimit më parë të kësaj pasurie në emer të shtetasit Klodian Zoto, në vijim në emer të shtetasit Gerian Kuka e më pas në pronësi të shtetasës Erjola Hoxha, bashkëjetuese e personit nën hetim Arben Ahmetaj.
- Fshehjes së pasurisë dhe deklarimit të rreme, të shumës prej 130 000 euro, në vitin 2017 dhe 2018, duke u mbuluar natyra e vërtetë e burimit dhe duke u paraqitur si pagesë e bërë shtetasve Albina Mançka dhe Arben Ahmetaj, përkundrejt një “shitje” ndaj shtetasit Besmir Prifti, të 1 (një) apartamenti me sipërfaqe 178.68 m² dhe 1 (një) garazhi, me sipërfaqe 21 m², ndodhur në ZK 3292, në vendin e quajtur Selitë, në pallatin e rëndërtuar nga shoqëria “*Sheron*” sh.p.k., vlerë kjo e paguar në mënyrë të tërthortë nga

shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, dhe subjekti tregtar “Integrated Technology Services” sh.p.k. nëpërmjet shtetasit Besmir Prifti;

- Fshehjes se pasurise dhe deklarimit te rreme, te shumës prej 140 000 euro, **në vitin 2018**, duke u mbuluar natyra e vërtetë e burimit dhe duke u paraqitur si pagesë e bërë shtetasve Albina Mançka dhe Arben Ahmetaj, përkundrejt një “shitje” ndaj shtetasve Sonila Goxhaj, të 1 (një) apartamenti me sip 178.68 m2 dhe 1 (një) garazhdi, me sip 21 m2, ndodhur në ZK 3292, në vendin e quajtur Selitë, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “Sheron” sh.p.k., vlerë kjo e paguar në mënyrë të tërthortë nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, nëpërmjet shtetasve Sonila Goxhaj, Sokol Meqemeja dhe shoqërisë “Frigo Food” sh.p.k.
- Fshehjes dhe deklarimit te rreme, te shumes totale te shpenzuar per investim ne Vilen nr. 22 Hamallaj, pasi nuk kane deklaruar vleren reale te shpenzimeve duke fshehur minimalisht shumen prej 137 000 euro te paguar nga shoqeria Egeu Stone sh.p.k. qe perfshin pjesen e rikonstruksionit, riparimit te ketij objekti (pa perfshre arredimin).

Gjithashtu, nga hetimet e kryera deri më tani, vlerësojmë se ekziston dyshimi se nga ana e personit nën hetim Arben Ahmetaj, është konsumuar vepra penale “*Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, në bashkëpunim, më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë i K.Penal, pasur parasysh të gjitha veprimet e kryera me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së pasurisë së paligjshme, të përfutur si pasojë e kompsionit ose burime të tjera të paligjshme.

Mbështetur në sa parashtruar më lart dhe shpjeguar në mënyrë të hollësishme në relacionin bashkalidhur kësaj kërkesë, bazuar në nenin 73 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 288 të K.Pr.Penale, nenet 13, 118 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nenet 103, 104, 279 të K.Pr.Penale, neni 295/a i K.Penal,

KËRKOJMË:

1. Dhënia e autorizimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për arrestimin/heqjen e lirisë dhe ushtrimin e kontrollit personal dhe të banesës së deputetit **Arben AËIMETAJ**
2. Shqyrtimin e kësaj kërkesë, në çdo procedurë që do të zhvillohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në seancë me dyer të mbyllura, për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor, pasur parasysh se hetimi i procedimit penal M. 277/1 i vitit 2022 ka si fokus edhe fakte të tjera penale dhe persona të tjere të implikuar në ndodhjen e ketyre fakteve.

PROKURORËT

ALTINIDUMANI

ENKELEDA MILLONAI

